



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 964/2 Prot.

Vlorë më, 11.05.2023

VENDIM
Nr. 15, datë 10.05.2023

E. Homor

PËR
HAPJEN DHE MIRATIMIN E TARIFËS SË SHKOLLOIMIT PËR PROGRAMIN E
STUDIMIT PËR PROGRAMIN E VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-
PEDAGOGJIKE

Në mbështetje të nenit 3, pika 3 gërma ç, nenit 49 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e lartë në Republikën e Shqipërisë" nenit 25, pika 1 gërma i, i Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2023 të MAS "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlerëshme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/ lëndën e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kritëret për hapjen e programeve të studimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", si dhe referuar shkresës së MAS nr. 1415/2, datë 26.04.2023, propozimit të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë me nr. 305/5 prot, datë 04.05.2023, shkresës së Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e parë dhe të dytë të studimeve nr. 938/1, datë 08.05.2023, shkresës nr.938/4 prot, datë 08.05.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 10.05.2023

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko- pedagogjike, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifën për programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në masën 35.000 lekë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Sotir NIKOLLA

